



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.T. nga Prishtina, për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit, avokatit N.I., të datës 13 janar 2020, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, P.nr.335/2018, të datës 23 dhjetor 2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 14 dhjetor 2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, avokatit N.I., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, P.nr.335/2018, i datës 23 dhjetor 2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, me aktgjykimin e lartcekur, përkatësisht me aktgjykimin e ankimuar, të akuzuarin A.T. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK dhe ndaj tij për shkak të kësaj vepre penale ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin dënim me pëlqimin e të akuzuarit ia ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 2500 € (dymijepesëqind Euro), e të cilin dënim i akuzuari është i detyruar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita

kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim sipas nenit 46 paragrafi 3 të KPRK.

Është detyruar i akuzuari A.T. që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 550 € (pesëqindpesëdhjetë Euro), në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 € (njëzet Euro) dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë Euro), të cilat është i detyruar t'i paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

I dëmtuari F.Z., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të akuzuarit, avokati N.I., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesën ta aprovoj në tërësi, ndërsa ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe ta shpall të pafajshëm të akuzuarin A.T..

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.371/2020, të datës 29 qershor 2020, ka propozuar që refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, avokatit N.I. theksohet se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që ndaj të pandehurit, aktakuza është ngritur pa aktvendim për fillimin e hetimeve, edhe pse vepra për të cilën është akuzuar i njëjti ka qenë e dënueshme deri në 10 (dhjetë) vjet burgim. Pastaj, fakti se aktakuza është ngritur pasi që kanë kaluar më tepër se dy vite nga data kur ka ndodhur rasti pa ndonjë kërkesë shtesë për vazhdimin e hetimeve, ashtu siç parashihet në nenin 159 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Shkelja tjetër esenciale e dispozitave të procedurës penale qëndron në faktin se gjykata nuk ka pranuar si provë skicën e rrugëve të fshatit Llaushë (të nxjerrë nga fotografimi satelitor), të ofruar nga mbrojtja në të cilën shihen rrugët alternative të cilat i ka pasur i dëmtuari dhe megjithatë ka hyrë në rrugën e ndaluar me shenja të komunikacionit të vendosura nga punë kryerësit, edhe pse siç ka deklaruar i dëmtuari i ka parë këto shenja dhe shenjën e punimeve në rrugë, me ç'rast gjykata ka bërë shkelje të nenit 384 paragrafi 2, nën-paragrafi 2.2 të KPP. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka dështuar ta vërtetoj gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe atë në shumë drejtime. Së pari, ka marrë aktgjykimin duke i falë besimin deklaratës së të dëmtuarit të dhënë në gjykatë, edhe pse kjo deklaratë shihet qartë se është e pavërtetë, kundërthënëse me deklaratën e dhënë në polici dhe e orkestruar vetëm për përfitim material, si dhe deklaratave të dëshmitarëve, të cilat kanë qenë të koordinuara në mes vete dhe plotësisht kontradiktore me deklaratat e dhëna në polici të cilat janë dhënë në ditën kritike, pastaj deklaratat e dhëna në gjykatë nga dëshmitarët janë marrë pa u vënë nën betim. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar e thekson se

gjendjen faktike e ka vërtetuar duke u bazuar në deklaratat e të dëmtuarit-dëshmitarit dhe dy dëshmitarëve tjerë, ndërsa nëse lexohet deklarata e dëshmitarëve me kujdes, mund të vërehet që gjykata këto deklarata i vlerëson në mënyrë jo të plotë dhe nuk e merr parasysh faktin që njëri nga dëshmitarët thekson që në të dy anët e kanalit ka pasur dhe. Gjithashtu, thekson që i dëmtuari ka rënë në kanalën e hapur nga punë kryerësi dhe për këtë punë nuk ka asnjë provë, e në arsyetim dhe dispozitiv theksohet se “i dëmtuari së pari ka goditur kubëzat e betonit, të cilat kanë qenë para kanalit”, ndërsa nga fotot e vendit të ngjarjes shihet që kubëzat e betonit të cilat janë hequr nga punë kryerësi, kanë qenë të vendosura në trotuar dhe jo në rrugë para kanalit, ashtu siç theksohet në aktgjykim, me ç’rast gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh provat që gjenden në shkresat e lëndës. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar as ekspertizën e komunikacionit, sipas së cilës shkaktar kryesor ishte i dëmtuari, i cili ka bërë dy shkelje, ndërsa punëdhënësi një shkelje e cila nuk ka ndikuar në shkaktimin e lëndimeve, për faktin se i dëmtuari ka deklaruar se i kam parë shenjat e trafikut me të cilat ka qenë i ndaluar qarkullimi në atë rrugë dhe po ashtu i ka parë shenjat paralajmëruese për punime në rrugë, prandaj në asnjë mënyrë nuk ekziston lidhja kauzale në mes të lëshimeve të punë kryerësit dhe lëndimeve që ka pësuar i dëmtuari. Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë, mbrojtësi i të akuzuarit i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si më lart.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPP, konstatoj se :

- ankesa është e pabazuar.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit janë të pabazuara. Kjo për faktin se aktgjykimin i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat pretendohet në ankesë, por as në shkelje tjera të kësaj natyre, për të cilat Gjykata e Apelit e Kosovës kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 nën-paragrafët 1.1.-1.3. të KPP. Aktgjykimin i ankimuar është përpiluar sipas ligjit, përkatësisht ashtu siç parashihet në nenin 370 të KPP. Dispozitivi i aktgjykimin të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe i njëjti i përmban të gjitha elementet që parashihen me ligj. Dispozitivi i aktgjykimin të ankimuar nuk është në kundërshtim me vetveten e as me arsyetimin e të njëjtit, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë mjaftë të plotë dhe të qartë të gjitha arsyet përkitazi me faktet vendimtare në këtë çështje penale. Në rastin konkret, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e ankimuar e ka bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilat prova janë analizuar dhe vlerësuar në mënyrën e duhur, pas së cilave është ardhur në përfundim nëse faktet konkrete vendimtare janë vërtetuar ose jo. Në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar janë paraqitur arsye të qarta dhe të mjaftueshme në lidhje me të gjitha provat mbi bazën e së cilave është vërtetuar se i akuzuari është kryerës i veprës penale, duke paraqitur

edhe arsye se pse i është falur besimi provave të caktuara, ndërsa nuk i është falur besimi provave tjera, e që rezulton se është bërë edhe vlerësimi i saktësisë së provave kundërthënëse. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konsideron që nuk është detyrë e gjykatës që në rastet e caktuara detyrimisht t'i aprovoj të gjitha propozimet e palëve në lidhje me administrimin e provave të reja, nëse provat përkatëse për të plotësuar provat tjera janë të panevojshme, pasi çështja në fjalë është e njohur në vija të përgjithshme, ashtu siç parashihet në nenin 258 paragrafi 2, nën-paragrafin 2.1. të KPP, ndërsa deklarata e të dëmtuarit, nuk ka qenë e vetmja provë, në bazë të të cilës janë vërtetuar faktet konkrete, kështu që pretendimet ankimore janë të pabazuara edhe në këtë drejtim. Në lidhje me çështjen e hetimeve dhe afatshmërisë së aktakuzës, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës nuk ka gjetur ndonjë shkelje të dispozitave përkatëse ligjore, për faktin se në rastin konkret janë zhvilluar hetimet sipas aktvendimit për fillimin e hetimeve të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, KT/II.nr.1454/18, të datës 13 qershor 2018, ku edhe janë ndërmarrë veprimet përkatëse hetimore për sigurimin e provave, e në këtë rast edhe të ekspertizës mjeko ligjore, si dhe ekspertizës së ekspertit të komunikacionit, ndërsa aktakuza është ngritur me datën 1 tetor 2018, e që do të thotë se e njëjta është ngritur brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 159 paragrafi 1 të KPP. Andaj, edhe në këtë drejtim, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit nuk qëndrojnë.

Në anën tjetër, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton që gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari A.T. është kryes i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor. Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari A.T. në mënyrën e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor pasi që me datën 30 gusht 2016, në fshatin Llaushë, Komuna e Skenderajt, në rrugën "Ramë Babaj", si person përgjegjës në kuadër të personit juridik N.N.P. "D...", ka kryer punët në kanalizim, duke mos iu përmbajtur rregullave teknike apo masave mbrojtëse në përputhje me nenin 11 pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe me këtë ka shkaktuar rrezikshmëri të madhe për jetën e njeriut, në atë mënyrë që një kanal ka qenë i hapur në gjerësi të rrugës, ndërsa vendi i kryerjes së punimeve nuk ka qenë i shënuar, ashtu që çiklisti F.Z., fillimisht ka goditur disa kubëza të betonit dhe më pastaj ka rënë në kanal, duke pësuar lëndime të rënda trupore në formë të plagës shqyese në ballë dhe në pjesën e majës së tepës së kokës, përdredhje të unazave të qafës dhe thyerjen e unazës së katërt torokale (në supe të boshtit kurrizor), ku edhe me atë rast është shpallur fajtor për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK. Siç rezulton edhe nga aktgjykimi i ankimuar, por edhe nga shkresat tjera të lëndës, deri tek kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit të disa provave, siç janë: dëgjimin e dëshmitarëve F.Z. (i dëmtuar), F.B., P.B., dëgjimin e ekspertëve të komunikacionit dhe atë, F.T. dhe S.B., ekspertizës mjeko-

ligjore, raporteve mjekësore, fotografive nga vendi i ngjarjes, ekspertizës së grupit të ekspertëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës, shkresave tjera, si dhe deklaramit të vet të akuzuarit. Nga shkresat e lëndës shihet që në rastin konkret, ekspertizat e ekspertëve F.T. dhe S.B. kanë qenë kundërthënëse në lidhje me atë se me lëshimet e kujt është ardhur deri te shkaktimi i aksidentit në ditën kritike. Andaj për ta sqaruar këtë çështje, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konsideron se drejtë ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur duke u bazuar në nenin 329 paragrafi 4 të KPP, sipas detyrës zyrtare ka vendosur që të caktohet një grup i ekspertëve për të dhënë mendimin e tyre në lidhje me atë se me lëshimet e kujt është ardhur deri tek aksidenti i lartcekur. Grupi i ekspertëve në përbërje prej Prof.Dr.M.B., Dr.N.L. dhe Mr.sc.H.P., nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës kanë konstatuar se aksidenti në fjalë ka ndodhur si pasojë e lëshimeve të biçiklistit dhe përgjegjësve të kompanisë N.N.P. “D...”, në këtë rast të akuzuarit A.T.. Sipas mendimit të grupit të ekspertëve, lëshimet e biçiklistit-të dëmtuarit F.Z. janë mosrespektimi i shenjës së trafikut dhe ndriçimi jo adekuat i biçikletës, ndërsa lëshimet e kompanisë N.N.P. “D...”, përgjegjës i së cilës ka qenë i akuzuari A.T., kanë qenë mënyra e shënimit të pengesave në rrugë, si dhe pajisjet për udhëheqjen dhe orientimin e komunikacionit në zonën ku ka ndodhur aksidenti, pasi që nuk është bazuar në rregulloren e fushës së rrugëve publike dhe sigurisë së trafikut rrugor. Në anën tjetër, se i dëmtuari kishte pësuar lëndime të rënda trupore vërtetohet edhe nga ekspertiza mjeko ligjore e ekspertit mjeko ligjor Dr. B.C., e cila kishte konstatuar lëndimet e paraqitura më lart, por edhe nga raportet mjekësore. Jo vetëm këto, por edhe prova tjera të theksuara më lart, përveç deklaramit të të akuzuarit në mënyra të ndryshme i vërtetojnë faktet përkatëse që janë të rëndësishme për të ardhur në përfundim se i akuzuari A.T. është kryerës i veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor. Duke u bazuar në këto prova të cilat janë administruar, vlerësuar dhe analizuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por edhe në provat tjera që gjenden në shkresa të lëndës, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për shkak se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari A.T. e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor me aktgjykimin e ankimuar. Andaj, edhe kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar, kështu që edhe pretendimet ankimore në këtë drejtim janë të pabazuara.

Gjithashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji penal në dëm të të akuzuarit, për të cilën bazë ankimore, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës kujdeset sipas detyrës zyrtare duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPP. Kjo për faktin se veprimet e të akuzuarit i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, se për këtë veprë penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të akuzuarit.

Meqë, është paraqitur ankesë në dobi të të akuzuarit për shkak vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, atëherë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës duke u bazuar në nenin 396 të KPP, aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare e ka shqyrtuar edhe përkitazi me dënimin e shqiptuar edhe pse nuk është paraqitur ankesë për këtë bazë ankimore. Në këtë drejtim, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Kështu, gjykata e shkallës së parë si rrethana lehtësuese për të akuzuarin kishte marrë për bazë se faktin se i akuzuari është i martuar, babë i dy fëmijëve, mbajtës i familjes dhe se deri tek aksidenti kishte ardhur edhe me lëshimet e të dëmtuarit, ndërsa si rrethanë rënduese është marrë për bazë mosha e re e të dëmtuarit. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë dhe duke i pasur në konsideratë edhe rrethanat tjera të rastit konkret, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit A.T. është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me cilësitë personale të të akuzuarit dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të tij. Gjithashtu, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i bindur se me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.354/2020, më datën 14 dhjetor 2020

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetare e kolegjit,
Shqipe Qerimi

Abdullah Ahmeti